



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

**SCC-09-0161**

*Paditësi*

**I B** Prishtinë.

**Kundër**

*E paditura*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rruga “Agim Ramadani”, nr. 23, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Hajrie Shala, me 22 tetor 2020, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. REFUZOHET si e pabazuar Padia e paditësit Ismet Bllaca.**
- II. Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin**

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 25 gusht 2009, paditësidorëzoi në Dhomën e Posaçme, padi kundër tëpaditurës Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), me të cilën kërkoi që të aprovohet kërkesa e tij si e bazuar dhe të obligohet e paditura që në emër të të ardhurave të papaguara personale për periudhën 36 mujore të ia paguaj shumën prej 25,200.00 € dhe atë brenda afatit prej 8 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kanosjen e përmbarimit me dhunë. Në mbështetje të padisë si provë ka bashkangjitur kërkesën e 10 gusht 2009 drejtuar AKP, vërtetimin e datës 04 shtator 2006, certifikatën e datës 26 shkurt 2007.

Me aktvendimin SCC-09-0161 të datës 24 nëntor 2009, Dhoma e Posaçme e ka hedhur poshtë padinë e paditësit si të pa pranueshme.

Me aktvendimin ASC-09-0099 të datës 01 shkurt 2011, Kolegji i Apelit të Dhomës së Posaçme e ka anuluar aktvendimin SCC-09-0161 të datës 24 nëntor 2009 dhe lëndën e ka kthyer në rigjykim.

Me 25 shtator 2020, e paditura AKP parashtroi përgjigje në padi, në të cilën pohoi se e kundërshton në tërësi padinë e paditësit duke e konsideruar si të pa bazuar në ligj. Më tej, e paditura pohoi se konsideron se kërkesa e dorëzuar nga paditësi me datë 10 gusht 2009 është parashtruar pas afatit për dorëzimin e kërkesave që ishte 15 shkurt 2007, në përputhje me Ligjin nr. 04/L-034 mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Po ashtu, e paditura pohoi se kërkesa duhej të jetë parashtruar në gjykatë brenda tre vjetësh apo autoritet tjetër nga koha kur NSH pretendohet te ketë dështuar të përmbush obligimin ndaj ankuesit i cili rrjedh nga marrëdhënia e punës.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësas apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala etillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio quidicit*).

Në këtë rast ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmon se NSH i ka mbetur borxhpagat e kërkuara, po ashtu ankuesi nuk ka dorëzuar ndonjë specifikacion se për cilët muaj i kërkon pagat, ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi lidhur me lartësinë dhe llogaritjen e pagave të kërkuara. Gjykata gjen se në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankuesit lidhur

me të drejtën e tij në kompensim përpagatë pa paguara, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Andaj, në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjyqimit.

### **Taksat gjyqësore**

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Në pajtim me nenet 8.1.2 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2017 për unifikimin e taksave gjyqësore (UA 1/2017), ankuesi lirohet nga pagesa e taksave gjyqësore për ankesën e parashtruar, pasi që paditësi është shfrytëzues të pensionit të pleqërisë.

### **Këshilla juridike**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gjyqtare

**Hajrie Shala**